

GJYKATËS SË APELIT TË KOSOVËS

përmes **GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS**
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

lidhur me lëndën **A. nr. 3090/19**

Paditës-propozuesi:

Sami Kurteshi, rr. Xhavit Ahmeti, nr. 9/A, 10000 Prishtinë
përfaqësuar me autorizim nga juristi Getoar Mjeku

ndaj të paditur-kundërpropozueses:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) e Republikës së Kosovës
rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000 Prishtinë

me palët e interesuara:

- (1) «Alsi & CO – Kosovë L.L.C» SH.P.K., nr. unik id. 810875552
- (2) «VBS» SH.P.K., nr. biz. 70325365
- (3) «Vita Energy» SH.P.K., nr. biz. 71218376
- (4) «Abrazen LLC», nr. biz. 70100453
- (5) «Energy Development Group Kosova» SH.P.K., nr. biz. 717276643
- (6) «Solar Gate LLC», nr. biz. 71280888
- (7) «Building Construction», pa adresë ose numër identifikimi
përfaqësuar me autorizim nga avokatët —
— Faton Qirezi, rr. Muharrem Fejza, hy. C15/15, nr. 23, 10000 Prishtinë
— Alban Makolli, rr. Muharrem Fejza, hy. C15/17, nr. 5, 10000 Prishtinë

PËRGJIGJE NË ANKESË

sipas Ligjit për procedurën kontestimore, neni 187.1
ndaj Ankesës së 22 prillit 2020 të palëve të interesuara, dorëzu. 8 qershor

Prishtinë, 15 qershor 2020

Përfaqësues i paditësit:

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
A. Përmbledhje.....	3
B. Çështje në shqyrtim.....	3
C. Arsyetimi juridik.....	4
II. Procedura dhe faktet.....	5
A. Procedura.....	5
B. Përmbledhje e fakteve.....	6
C. Fakte të reja.....	7
E paditura ka pohuar publikisht dëmin ndaj konsumatorëve.....	7
Hetime për ndihmë të kundërligjshme shtetërore dhe vepër penale.....	7
Tarifat për diellore — Shqipëri 24,89 euro, Kosovë 85,5.....	7
III. Prova.....	8
IV. Argumentet.....	9
A. Ankesa e palejueshme: Palë pa subjektivitet juridik.....	9
B. Ankesa e pathemeltë: Themeloria ka rivendosur çështjen sipas rekomandimeve të Apelit.....	11
Ka marrë parasysh provat e reja.....	11
LKA, vendimi i Kushtetueses dhe Apeli lejojnë padinë.....	11
LKA lejon shtyrjen e ekzekutimit.....	12
C. Ankesa e pathemeltë: Janë plotësuar kushtet për shtyrje.....	13
Dëmi është i pariparueshëm.....	13
Interesi publik kërkon shtyrjen.....	17
Palët e interesuara nuk dëmtohen, madje përfitojnë nga shtyrja.....	18
D. Ankesa e palëve ka të meta thelbësore.....	19
Lëshohet në meritat e padisë.....	19
Keqparaqet faktet dhe ligjin.....	20
V. Propozim.....	22

I. HYRJE

A. Përmbledhje

1. Sipas ligjit, Gjykata miraton kërkesën për shtyrje ekzekutimi të një vendimi administrativ nëse plotësohen tri kushte: (1) ekzekutimi i vendimit i sjell dëm vështirë të riparueshëm paditësit; (2) shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik; dhe (3) shtyrja nuk u shkakton «dëm të madh» palëve të interesuara.¹
2. Ky rast ka të bëjë me vendim të organit rregullator që do të shtrenjtonte rrymën. Së pari, vendimi shkakton dëm të pamatshëm e të riparueshëm, duke ua ngarkuar konsumatorëve dhjetëra miliona euro, që mund të përkthehen në qindra a mijëra për secilin. Së dyti, shtyrja është në përputhje me interesin publik, sepse mbron konsumatorin dhe tregun e lirë, mbron pronën nga tjetërsimi i paligjshëm dhe parandalon pasurimin e pabazë. Së treti, shtyrja nuk i pakëson fare (dhe qebesa rrit) përfitimet e palëve të tjera nga vendimi i goditur, meqë ato zgjasin për periudhë fikse 12-vjeçare, pa marrë parasysh se kur fillon zbatimi.
3. Paditës-propozuesi Sami Kurteshi ka dëshmuar arsyet për shtyrje me argumente e prova bindëse, në parashtrësën fillestare, në tri përgjigje në ankesa dhe në dy parashtrësë plotësuese. Kështu ka paraqitur edhe provat që Apeli i ka cilësuar të munguara herën e parë. Gjykata Themelore ka vërejtur plotësimet e zotit Kurteshi, andaj ka vendosur drejt kur herën e dytë ka miratuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit.
4. Me këtë përgjigje, z. Kurteshi i kërkon Gjykatës së nderuar të hedhë poshtë ankesën e dy prej palëve, që u mungon interesi ose subjektiviteti juridik, dhe të refuzojë ankesën sa u përket palëve të tjera. Përfundimisht, Gjykata duhet të vërtetojë Aktvendimin e 6 prillit për shtyrje të ekzekutimit.

B. Çështje në shqyrtim

5. Në shqyrtim para Gjykatës janë këto tri çështje kryesore:

1 Ligj 03/L-202 për konfliktet administrative (LKA), neni 22.2.

- (1) Ligji s'lejon me paraqitë ankesë pa pasur interes juridik ose pa qenë person fizik a juridik.² «VBS» SH.P.K. dhe «Building Construction» nuk janë identifikuar si persona juridikë ose biznese të regjistruara me numër e adresë të saktë. A u lejohet ankesa?
- (2) Ligji kërkon që gjykata e shkallës së parë të marrë parasysh rekomandimet e shkallës së dytë kur rivendos një çështje.³ Themeloria ka miratuar kërkesën, duke vërejtur se propozuesi ka paraqitur prova shtesë, sipas rekomandimit të Apelit. A ka vepruar drejt Gjykata Themelore?
- (3) Ligji lejon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ nëse paditësit i kanoset dëm vështirë i riparueshëm, shtyrja nuk cenon interesin publik, dhe shtyrja s'u shkakton «dëm të madh» palëve të interesuara.⁴ Themeloria ka shtyrë përmbarimin e një vendimi për të subvencionuar disa prodhues të energjisë. Vendimi rrezikonte shtrenjtimin e rrymës për konsumatorët si paditësi. Shtyrja nuk cenon interesin publik, sepse mbron konsumatorin e tregun. As u sjell dëm të madh të interesuarve, meqë ata s'kanë investuar si pasojë e vendimit, dhe subvencionet jepen për kohë fikse, kurdo që të fillojnë. A ka vepruar Themeloria sipas ligjit e fakteve?

C. Arsyetimi juridik

6. Në procedurën ankimore ndaj aktvendimit vlejné rregullat e aktgjykitimit.⁵ Ankesa dhe përgjigjja dorëzohen në gjykatën e shkallës së parë. Kur pala e pakënaqur parashtron ankesë, gjykata ia dërgon një kopje palës tjetër, e cila mund të paraqesë përgjigje brenda 7 ditësh.⁶ Ankesa e palëve i është dorëzuar përfaqësuesit të paditës-propozuesit më 8 qershor 2020. Paditës-propozuesi po paraqet këtë përgjigje në gjykatën e duhur dhe brenda afatit, andaj përgjigjja duhet të shqyrtohet.

2 Ligj 03/L-006 për procedurën kontestimore, ndryshuar me ligjin 04/L-118 (LPK), nenet 186, para. 1 dhe 3, dhe 196.

3 LPK, neni 199.

4 LKA, neni 22.

5 LKA, neni 63; LPK, neni 208.

6 LPK, neni 187.1.

II. PROCEDURA DHE FAKTET

A. Procedura

7. Më 24 dhjetor 2019, paditës-propozuesi Kurteshi ka parashtruar padi ndaj një vendimi të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE), duke kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Gjykata Themelore e Prishtinës ka miratuar kërkesën me Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019.
8. Gjatë janarit dhe shkurtit 2020, e paditur-kundërpropozuesja ZRrE dhe dy palë të interesuara kanë paraqitur ankesa të ndara ndaj Aktvendimit të 27 dhjetorit.⁷ Z. Kurteshi ka deponuar përgjigje në secilën ankesë, brenda afatit ligjor.⁸
9. Më 20 shkurt 2020, Gjykata e Apelit ka prishur Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019, dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim.⁹ (Për arsye të panjohura për ne, nga tri përgjigjet e z. Kurteshi në ankesat e palëve, Apeli përmend vetëm përgjigjen në ankesën e së paditurës, ZRrE.)
10. Më 4 mars 2020, Gjykata Themelore e Prishtinës ka nxjerrë aktvendim, i cili i kërkonte paditës-propozuesit që brenda 8 ditësh të dorëzonte «prova apo fakte të bindshme» për të mbështetur kërkesën për shtyrje të ekzekutimit. Aktvendimi i është dorëzuar përfaqësuesit të paditësit më 9 mars 2020.
11. Më 5 mars 2020, ende pa iu njoftuar Aktvendimi i 4 marsit, paditës-propozuesi i është drejtuar Themelores me një parashtresë të veçantë, që përsërit kërkesën për shtyrje ekzekutimi dhe tërheq vëmendje ndaj provave kyçe.
12. Më 12 mars 2020, paditësi Kurteshi ka dorëzuar parashtresën dhe provat plotësuese të kërkuara me Aktvendimin e 4 marsit. Parashtresa ka shtjelluar në hollësi ndikimin që tarifata e caktuara nga ZRrE kanë mbi konsumatorët, duke përfshirë zotin Kurteshi.

7 Ankesë e së paditurës, 23.1.2020, dorëzuar 28.1.2020; Ankesë e palës së interesuar, 13.2.2020, dor. 7.2.2020; Ankesë e palës së interesuar, 10.2.2020, dor. 20.2.2020.

8 Përgjigje në ankesën e së paditurës, 30.1.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 13.2.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 21.2.2020.

9 Aktvendim AA.nr.155/2020, GjAK, 20.2.2020.

13. Duke u mbështetur në parashtrësën e 12 marsit dhe provat plotësuese të dorëzuara nga z. Kurteshi, Gjykata Themelore e Prishtinës ka rivedosur shtyrjen e ekzekutimit me Aktvendimin e 6 prillit 2020.
14. Një varg palësh të interesuara, që përfshijnë ankues të mëparshëm dhe një biznes pa subjektivitet juridik të dëshmuar, kanë parashtruar ankesë më 22 prill. Meqë gjykatat kanë qenë pjesërisht të mbyllura për shkak të pandemisë së koronavirusit, ankesa nuk i është dorëzuar përfaqësuesit të paditës-propozuesit deri më 8 qershor 2020.

B. Përmbledhje e fakteve

15. Paditës-propozuesi Sami Kurteshi është shtetas i Republikës së Kosovës dhe konsumator i energjisë elektrike.¹⁰
16. E paditur-kundërpropozuesja Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) e Republikës së Kosovës cakton tarifat, që përfundimisht paguhen prej konsumatorëve.
17. Për shkak të kostos dhe rëndësisë, *burimet e ripërtërishme të energjisë* (BRE) gëzojnë trajtim të veçantë në vendimet e rregullatorit. BRE përfshin ujin, diellin, erën, biomasën dhe burime të tjera.
18. Më 27 nëntor 2019, ZRrE ka nxjerrë vendim për një skemë mbështetëse të prodhimit të energjisë diellore (fotovoltaike). Vendimi parasheh tarifa nxitëse (*feed-in*) prej 85,5 eurosh për megavat orë.¹¹ Kjo tarifë është dukshëm mbi çmimin e tregut, dhe shërben si subvencion.
19. Nga skema e ZRrE-së përfiton një listë prodhuesish, që kanë qenë të ditur shumë para se të merrej vendimi. Skema do të mbështesë kapacitetin prej 20 MWh, me një kufizim prej 3 MW për prodhues. Por gati të gjithë prodhuesit — me përjashtim të njërit — kanë një adresë, një vend operimi dhe gjasshëm të njëjtin pronar.¹²
20. Skema mbështetëse do të vazhdojë për një periudhë 12-vjeçare.

10 Parashtrësë e paditësit, 12.3.2020, shtojca 1: Faturë e energjisë elektrike.

11 Vendimin V_1204, ZRrE, 27.11.2019, para. VI.

12 Shih dhe provën e propozuar në para. 22 të kësaj përgjigjeje, më poshtë.

C. Fakte të reja

21. Që nga parashtrirat e fundit, kanë ndodhur një sërë zhvillimesh të reja që kanë lidhje me rastin.
22. Në prill 2020, një rrjet i respektuar i gazetarisë hulumtuese ka transmetuar në televizion kombëtar një emision lidhur me vendimin e ZRrE-së për subvencionimin e energjisë diellore.

Provë: Shtojca 1 (me videon në rrjet)

E paditura ka pohuar publikisht dëmin ndaj konsumatorëve

23. Në përgjigje për emisionin, e paditura ZRrE ka pranuar se subvencionet u faturohen përfundimisht konsumatorëve. Madje, ka vlerësuar se gjithsej konsumatorët do të paguajnë 27,6 milionë euro. Kjo shumë tejkalon përlllogaritjet tona konservatore, që kanë dhënë 16,46 milionë euro.¹³

Hetime për ndihmë të kundërligjshme shtetërore dhe vepër penale

24. Emisioni ka ngritur shqetësimin se shumica e përfituesve të skemës kanë të njëjtin pronar.
25. Pas emisionit, janë vënë në lëvizje dy organe shtetërore për të hetuar rastin. Fillimisht ka nisur dosje Komisioni i Ndihmës Shtetërore, dhe pastaj Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Prova: Shtojca 2
Shtojca 3

Tarifat për diellore — Shqipëri 24,89 euro, Kosovë 85,5

26. Në maj 2020, Shqipëria ka përmbyllur ankandin për një park fotovoltai. Tavani ka qenë 55 euro për MW, ndërsa oferta fituese ka dhënë çmimin 24,89 euro.

Provë: Shtojca 4

13 Shtojca 1, videoja në rrjet, nga 00:33:00.

III. PROVA

27. Rregullat e procedurës kontestimore, që zbatohen përshtatshmërisht në konfliktin administrativ, lejojnë palët të parashtrojnë fakte e prova të reja, që propozuesi nuk ka mundur t'i njohë ose zotërojë më parë, për shkaqe objektive.¹⁴
28. Kësaj përgjigjeje i bashkëngjesim këto shtojca si prova të reja për fakte që kanë ndodhur pas parashtresës së fundit:

Shtojca 1 Kallxo, «Monopoli me dritë të diellit», emisioni *Jeta në Kosovë*, Kallxo.com, 30.4.2020, videoja në rrjet, <https://kallxo.com/emisione/monopoli-me-drite-te-diellit/>

Shtojca 2 Drenushë Ramadani, «Hulumtimi i emisionit “Jeta në Kosovë”, Komisioni nis hetime për vendimin e ZRRE-së për të ndihmuar bizneset e Devollëve», Kallxo.com, 8.5.2020, <https://kallxo.com/lajm/hulumtimi-i-emisionit-jeta-ne-kosove-komisioni-nis-hetime-per-vendimin-e-zrre-se-per-te-ndihmuar-bizneset-e-devolleve/>

Shtojca 3 Blerta Iberdemaj, «Prokuroria Speciale hap dosje pas hulumtimit të “Jeta në Kosovë”», Kallxo.com, 14.5.2020, <https://kallxo.com/emisione/jeta-ne-kosove/prokuroria-speciale-hape-dosje-pas-hulumtimit-te-jeta-ne-kosove>

Shtojca 4 Dosja.al, «“Çmim rekord”, shpallet fituesi i ankandit për parkun fotovoltaik të Karavastasë», 27.5.2020, <https://dosja.al/cmim-rekord-shpallet-fituesi-i-ankandit-per-parkun-fotovoltaik-te-karavastase/>

14 LPK, neni 180.

IV. ARGUMENTET

29. Së pari, Gjykata Themelore ose Gjykata e Apelit duhet ta hedhë poshtë si të palejueshme ankesën e palëve «VBS» SH.P.K. dhe «Building Construction». Së dyti, Gjykata e Apelit duhet ta refuzojë si të pathe-meltë ankesën e palëve të tjera, që janë palë të interesuara.
30. Gjykata e Apelit duhet ta vërtetojë Aktvendimin e 6 prillit 2020 të Gjykatës Themelore, e cila ka rivendosur të shtyjë përmbardimin e aktit të ZRrE-së. Themeloria ka arritur në këtë përfundim duke marrë para-sysh rekomandimet e shkallës së dytë për provat që kërkohen dhe duke u mbështetur në parashtrësën e paditës-propozuesit, i cili argu-menton në përpikëri bazën për shtyrje ekzekutimi, sipas nenit 22 LKA.
31. Në këtë kaptinë të përgjigjes, paraqesim argumentet të ndara në katër seksione. Në seksionin e parë shtjellojmë arsyet mbi palejueshmërinë e ankesës. Në dy seksionet vijuese argumentojmë se Themeloria ka vendosur drejt çështjen. Në seksionin e fundit tërheqim vërejtjen për të meta thelbësore të ankesës së palëve, që përfshijnë diskutime mbi me-ritat e padisë dhe shtrembërime të fakteve dhe ligjeve.

A. Ankesa e palejueshme: Palë pa subjektivitet juridik

32. Gjykata kujdeset për legjitimitetin e palëve ndërgjyqëse sipas detyrës zyrtare. Themeloria ose Apeli hedh poshtë si të palejueshme ankesën nga palët e paautorizuara ose pa interes juridik.¹⁵ Pala që nuk është as person fizik as person juridik nuk mund të ushtrojë ankesë.
33. Në hyrje të ankesës, të nënshkruar dhe vulosur nga dy avokatë, figu-rojnë «palët me interes juridik» që kanë ngritur ankesën, gjithsej 7 biz-nesë, të cilat thonë se merren me energjetikë. Por jo të gjitha janë sho-qëri tregtare të regjistruara ose të identifikuar siç duhet.
34. I dyti në listë është ankuesi «VBS» SH.P.K., që ka vënë për identifi-kim numrin e biznesit 70325365. Por në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit, ky numër i përket një entiteti tjetër, «Birra Peja» SH.A.¹⁶

15 LPK, nenet 186, para. 1 dhe 3, dhe 196.

16 Shih shënimet në ARBK, <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=2,38,44359>.

Ndërkaq, dy shoqëri shfaqen me emrin «VBS», çka e bën të pamundur të identifikojmë palën e saktë dhe të konkludojmë se pala ka interes juridik për ankesën.

35. I fundit në listë është ankuesi «Building Construction». Ndonëse pretendon të jetë person juridik, nuk është i tillë. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve nuk ka asnjë entitet, vendor a të huaj, të regjistruar me emrin «Building Construction». Në 16 faqe ankesë, nuk ka as emër biznesi të regjistruar, as adresë fizike të palës, as numër identifikues. Ankuesi nuk ka personalitet juridik, andaj nuk mund të ushtrojë mjete juridike siç janë padia dhe ankesa.
36. Nëse ankuesi është i regjistruar në një shtet tjetër nuk ka aspak rëndësi; për të vepruar në Kosovë dhe për të përfituar nga një skemë e ZRrE-së, lypset me pasë biznes të regjistruar në Kosovë. Përndryshe, s'mund të ketë as interes juridik në ecurinë gjyqësore me ZRrE-në.
37. Bizneset «VBS» dhe «Building Construction» nuk kanë qenë as palë në procedurën administrative pranë ZRrE-së.
38. Në pamundësi për ta dëshmuar legjitimitetin e vet, ankuesit kanë provuar të sulmojnë të drejtën e zotit Kurteshi për ta paditur ZRrE-në. Por këtë të drejtë z. Kurteshi e gëzon në sajë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në rastin *Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut*, që ua njeh qytetarëve interesin juridik për të sfiduar tarifat që i cakton shteti.¹⁷ Legjitimiteti i paditësit është argumentuar mirë në parashtresën fillestare dhe në këtë përgjigje.¹⁸
39. Rrjedhimisht, ankesa e palëve «VBS» SH.P.K. dhe «Building Construction» duhet hedhur poshtë si e palejueshme. Dhe sa herë përmendet ankuesit ose palët e interesuara, si parashtresë të ankesës, duhet nënkuptuar palët e tjera, pa «VBS» SH.P.K. dhe «Building Construction».

17 KI 11/09, *Krasniqi k. RTK dhe KEK*, Vendim, GjK, 16.10.2009, f. 3, para. fundit.

18 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, 24.12.2019, pjesa IV.C, para. 42–45.

B. Ankesa e pathemeltë: Themelorja ka rivendosur çështjen sipas rekomandimeve të Apelit

Ka marrë parasysh provat e reja

40. Kur rivendos çështjen, gjykata e shkallës së parë duhet të marrë parasysh konstatimet e shkallës së dytë.¹⁹ Në rastin tonë, Apeli ka vërejtur se Themelorja, kur ka nxjerrë Aktvendimin e 27 dhjetorit, «nuk ka mundur ti vlerësoj fare faktet dhe provat sepse, të njëjtat nuk janë paraqitur me propozim».²⁰
41. Mirëpo z. Kurteshi ka paraqitur prova shtesë me parashtresën e 12 marsit 2020. Parashtrësja përmban gjashtë shtojca, prej të cilave katër janë dokumente të paraqitura për herë të parë në gjykatë.²¹
42. Tutje, ka shpjeguar në hollësi dhe me shifra se do të pësojë dëm të pariparueshëm, se shtyrja është në përputhje me interesin publik dhe se shtyrja nuk ka për të dëmtuar palët e interesuara. Pra, ka plotësuar secilën nga tri kushtet për shtyrje të ekzekutimit, sipas nenit 22 LKA.

LKA, vendimi i Kushtetueses dhe Apeli lejojnë padinë

43. Ligji për konfliktet administrative lejon padi ndaj aktit përfundimtar që rrjedh nga procedura administrative.²² Edhe Ligji për rregullatorin e energjisë parasheh që vendimet e bordit të ZRrE-së të kundërshtohen përmes padisë në gjykatë.²³ Vetë vendimi i ZRrE-së thekson se është përfundimtar në procedurë administrative, dhe udhëzon palët në konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.²⁴
44. Padi për konflikt administrativ mund të ushtrojë cilado palë e tretë, person fizik a juridik, interesin e së cilës e prek vendimi i goditur — qoftë drejtpërdrejt, qoftë tërthorazi.²⁵ Në rastin *Krasniqi kundër RTK-së dhe KEK-ut*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka

19 LPK, neni 199.

20 Aktvendim AA.nr.155/2020, GjAK, f. 3, para. 3 (parafundit).

21 Parashtrësë e paditësit, 12.3.2020, para. 12; shih dhe para. 43–47, më poshtë.

22 LKA, nenet 13.2 dhe 27.1.

23 Ligj 05/L-084 për rregullatorin e energjisë, neni 49.

24 Vendimin V_1127_2019, ZRrE, 28.3.2019.

25 LKA, 03/L-202, nenet 10.1 dhe 21.

njohur të drejtën e qytetarëve për të sfiduar tarifën të cilat duhet të paguajnë për shkak të një vendimi shtetëror.²⁶

45. Në rastin tonë, z. Kurteshi është palë interesi i së cilës dëmtohen me vendimin e së paditurës. Paditësi është konsumator i energjisë elektrike. Subvencionet në formë të tarifave nxitëse, dukshëm mbi çmimin e tregut, ndikojnë në shtrenjtimin e rrymës për konsumatorët. Vetë e paditura e pranon se konsumatorët duhet të paguajnë subvencionet.²⁷
46. Konsumatorët vërtet kanë qenë me fat që rryma nuk është shtrenjtuar sivjet. Por kjo ka ndodhur për shkak të Aktvendimit të 6 prillit, që ka shtyrë ekzekutimin e vendimit të ZRrE-së për subvencione. Duke qenë se subvencionet për 20 MW nga burimet diellore kanë qenë të pezulluara, ZRrE nuk ka ngritur tarifën për konsumatorin fundor, kur ka vendosur për këtë çështje më 17 prill. Tani ankuesit pretendojnë gabimisht se padia e zotit Kurteshi është e parakohshme, sepse vendimi i ZRrE-së nuk ka shtrenjtuar rrymën. Nuk e ka shtrenjtuar, sepse ka qenë i pezulluar — dhe pezullimi apo shtyrja dëshmon interesin e paditësit.
47. Padinë e ka parashtruar pala e duhur dhe në kohën e duhur. Ligji, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por dhe tri aktvendimet që gjykatat kanë nxjerrë për rastin tonë njohin legjitimitetin aktiv të paditësit.

LKA lejon shtyrjen e ekzekutimit

48. Neni 22 LKA lejon shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ. Ndër të tjera, në Aktvendimin e 20 shkurtit, Gjykata e Apelit ka theksuar se Themeloria duhet të vendosë në përputhje me nenin 22 LKA. Aktvendimi i 6 prillit konstaton se paditës-propozuesi ka ofruar dëshmi për secilin kusht për shtyrjen e përmbarimit, sipas nenit 22 LKA.
49. Rrjedhimisht, Themeloria ka rivendosur çështjen në përputhje të plotë me rregullat e procedurës, dhe pretendimi i ankuesve për shkelje procedurore nuk qëndron. Gjykata e Apelit në këtë rast duhet ta refuzojë ankesën.

26 KI 11/09, *Krasniqi k. RTK dhe KEK*, Vendim, GjK, 16.10.2009, f. 3, para. fundit.

27 Shih provën e propozuar në para. 23, sipër.

C. Ankesa e pathemeltë: Janë plotësuar kushtet për shtyrje

50. Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRrE-së mbështetet në nenin 22 të Ligjit për konfliktet administrative. Sipas paragrafit 6 të atij neni, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës shtyrjen e ekzekutimit të vendimit administrativ. Sipas paragrafit 2 të nenit 22, gjykata miraton kërkesën e paditësit nëse:
- (1) ekzekutimi i shkakton paditësit dëm që vështirë riparohet;
 - (2) shtyrja nuk cenon interesin publik; dhe
 - (3) shtyrja nuk i sjell «dëm të madh» palës së interesuar.
51. Aktvendimi i 6 prillit thotë qartë se mbështetet në parashtrësat e paditës-propozuesit, të cilat arsyetojnë në përpikëri shtyrjen e ekzekutimit. Në veçanti, parashtrësa e 12 marsit ka dëshmuar — me argumente, prova dhe formula matematikore — se janë plotësuar kushtet për shtyrje. Për më tepër, parashtrësa hedh poshtë pretendimet e gabuara që ankuesit përsërisin në ankesë.
52. Për këto arsye, ne po përsërisim në vijim argumentet e parashtrësës së 12 marsit, për të shpjeguar bazën për shtyrje të ekzekutimit. Në thelb, rikujtojmë se vendimi i ZRrE-së shkakton dëm vështirë të riparueshëm, se shtyrja është në përputhje me interesin publik, dhe se shtyrja në fakt favorizon palët e interesuara në afat të gjatë.

Dëmi është i riparueshëm

53. Vendimi i ZRrE-së shtrenjton rrymën elektrike, duke ua ngarkuar të paktën 16,46 milionë euro paditësit dhe konsumatorëve të tjerë. ZRrE tani pranon se shuma arrin në 27,6 milionë euro gjithsej apo 2,29 milionë euro në vit.²⁸ Ky dëm pasuror (dhe çfarëdo dëmi tjetër përcjellës) nuk do të riparohet dot pas zgjidhjes përfundimtare të kontestit.

Kostoja e BRE-së

54. Burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE) kushtojnë më shtrenjtë se burimet tradicionale si thëngjilli. ZRrE miraton çdo vit të hyrat maksi-

28 Shih para. 22–23 të kësaj përgjigjeje, sipër.

male të lejuara për operatorët, duke u mbështetur në raporte konsultative që imtësojnë kostot dhe të hyrat për kategori të ndryshme.²⁹

55. Për vitin 2019, në raportin konsultativ për të hyrat e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), fondi për BRE ka qenë 12,45 milionë euro. Raporti konsultativ për furnizuesin me shërbim universal jep koston prej 10,8 milionë euro për BRE më 2019.³⁰
56. Më 2018, tarifat e paguara për BRE kanë kaluar shumë 9 milionë euro. Këtë shifër e kemi dhënë si provë edhe në padinë fillestare, duke u mbështetur në të dhënat e KOSTT-it.³¹
57. Kur kemi dorëzuar parashtrësën e 12 marsit, kostoja për 2020 ka qenë në përcaktim e sipër. ZRrE atëherë kishte pranuar propozimet e operatorëve për të hyrat maksimale të lejuara, dhe pritej të vendoste gjatë atij muaji. Operatori KESCO kishte propozuar 13,15 milionë euro për BRE.³²

Dëmi nga vendimi i 27 nëntorit 2019

58. Si provë, në padinë dhe kërkesën fillestare kemi paraqitur llogaritjen e barrës financiare që vendimi i 27 nëntorit 2019 ua hedh konsumatorëve. Këtë dokument, që është përpiluar në emër të paditësit me referenca në standardet e sektorit dhe dokumentet zyrtare të ZRrE-së, e parashtruam sërish më 12 mars, për të dëshmuar dëmin që i kanoset paditësit. Gjatë periudhës sa do të zbatohet, vendimi i ZRrE-së do t'u kushtojë konsumatorëve të paktën 16,46 milionë euro.³³ Por gjasat janë për barrë 27,6 milionë.³⁴

29 Shih Vendimin V_1127_2019, ZRrE, 28.3.2019.

30 Parashtrësë e paditësit, 12.3.2020, shtojca 2: ZRrE, Raport konsultativ: Përshtatjet vjetore të të hyrave të lejuara maksimale për KOSTT (prill 2019–mars 2020), mars 2019, bit.ly/38ApQ4Y, f. 11; shtojca 3: ZRrE, Raport konsultativ për të hyrat e lejuara maksimale: Furnizuesi me shërbim universal: Viti relevant tarifor 2019, mars 2019, bit.ly/3cO3Dnm, f. 9.

31 Po aty, shtojca 5: Pagesat vjetore për BRE, 2018.

32 Po aty, shtojca 4: KESCO, Propozim për të hyrat e lejuara maksimale për vitin tarifor 2020, 21.1.2020, bit.ly/3cJtexT, f. 17.

33 Po aty, shtojca 6: Ndikimi i tarifave nxitëse në çmimin e energjisë elektrike – pagesa shtesë e cila do të paguhet nga konsumatorët.

34 Shih para. 22–23 të kësaj përgjigjeje, sipër.

59. Te llogaritja arrihet duke marrë parasysh standardin industrial dhe tarifën e parapara me vendimin e ZRrE-së.
60. Standardi industrial llogarit se panelet diellore prodhojnë energji të paktën 4 orë në ditë. Andaj, kapaciteti prej 20 MWh shumëzohet me 4 për të nxjerrë minimumin e energjisë së prodhuar brenda ditës:

$$\begin{array}{rcl} 20 \text{ MWh} & \times & 4 \\ \textit{kapaciteti} & \textit{orë} & \textit{kapaciteti ditor minimal} \end{array} = 80 \text{ MWh në ditë}$$

61. Nga minimumi i kapacitetit ditor, nxjerrim minimumin e kapacitetit vjetor:

$$\begin{array}{rcl} 80 \text{ MWh} & \times & 365 \\ \textit{kapaciteti min.} & \textit{ditë} & \textit{kapaciteti vjetor minimal} \end{array} = 29.200 \text{ MWh në vit}$$

62. Në llogaritjet e paraqitura në padi, kapacitetin vjetor minimal e kemi zbritur edhe më shumë — nga 29.200 në 28.000 MWh — për të lënë hapësirë për dështime, mirëmbajtje a riparime, sado të rralla a të pagjashme të jenë. Nga ky vlerësim minimal pastaj përftojme koston për konsumatorët.
63. Koston minimale vjetore e nxjerrim duke shumëzuar kapacitetin vjetor me ndryshimin mes tarifës nxitëse dhe çmimit referent.
64. Tarifa nxitëse, e caktuar me vendimin e 27 nëntorit, është 85,5 euro.³⁵
65. Çmimi referent është mesatarja e çmimeve të energjisë nga burimet e tjera. Atë e nxjerrim nga llogaritjet më të fundit të ZRrE-së për të hyrat maksimale që u lejohen operatorëve të energjisë — tani është 35,6 euro.³⁶
66. Rrjedhimisht, shuma minimale që u vishet konsumatorëve çdo vit del:

$$\begin{array}{rcl} 28.000 \text{ MWh} & \times & (85,5 \text{ €} - 35,6 \text{ €}) \\ \textit{kapaciteti min.} & \textit{(tarifa - çmimi ref.)} & \textit{kostoja vjetore min.} \end{array} = 1.397.200,00 \text{ €}$$

³⁵ Vendimin V_1204, ZRrE, 27.11.2019, para. VI.

³⁶ Parashtrësë e paditësit, 12.3.2020, shtojca 2, sipër, f. 7.

$$\begin{array}{rclcl}
 1.397.200,00 \text{ €} & \times & 12 & = & 16.766.400,00 \text{ €} \\
 \textit{kostoja vjetore} & & \textit{vjet} & & \textit{kostoja minimale gjithsej}
 \end{array}$$

68. Në llogaritjen bashkëngjitur padisë, çmimi referent është dhënë në 36,5 euro (jo 35,6), çka bën që kostoja vjetore dhe kostoja e gjithsejtë të dalin më të ulëta: 1.372.000,00 euro në vit dhe 16.464.000,00 euro për 12 vjet.³⁷
69. Këto shifra janë tejet konservatore. Siç vumë re, e paditura ZRrE tashmë ka pohuar publikisht se kostoja për konsumatorët do të mbërrijë 27,6 milionët.³⁸ Për korrektësi ndaj gjykatës, ne jemi treguar ende më të matur. Kemi llogaritur minimumin e prodhimit ditor, ani pse panelet diellore prodhojnë më shumë se 4 orë në ditë. Pastaj, kemi zbritur rreth 12 mijë MWh çdo vit për mirëmbajtje e pengesa të paplanifikuara — në pyetje janë gati 1 milionë euro dallim. Në fund, kemi llogaritur koston minimale kundrejt të hyrave maksimale të lejuara. Këto rrethana dëshmojnë se barra mbi konsumatorët lehtë mund të kapërcejë shumën prej 27 milionë eurosh. Për një konsumator të rëndomtë si z. Kurteshi, barra sillet nga qindra në mija euro.

Pariparueshmëria e dëmit

70. Gjykata duhet të shtyjë ekzekutimin e vendimit kur dëmi që i shkaktohet paditësit është vështirë i riparueshëm.³⁹ Së pari, dëmi ndaj zotit Kurteshi dallon nga dëmi që rëndom kompensohet me të holla. Së dyti, do të jetë thuajse e pamundshme me i llogaritur saktë dëmet.
71. Mbështetur në jurisprudencën e Strasburgut dhe kushtetutën e vendit, pagesa e tarifës përbën lloj tatimi ose marrje të pronës.⁴⁰ Këtu z. Kurteshi nuk po kërkon kompensim të dëmit, as po përqendrohet te dëmi që ka ndodhur në të shkuarën, por po lut Gjykatën e nderuar ta paraandalojë *dëmin në të ardhmen*. Thënë ndryshe, paditësi nuk po lyp para, por po kërkon mos me ia marrë ato që i ka.

37 Po aty, shtojca 6, sipër.

38 Shih para. 22–23 të kësaj përgjigjeje, sipër.

39 LKA, neni 22.2.

40 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, 24.12.2019, para. 52–53.

72. Z. Kurteshi ka në pronësi dhe në posedim sendin që dëshirojnë t'ia marrin të tjerët. Tani ai po lyp me mbajtë sendin deri kur gjykata të vendosë nëse është e ligjshme me ia marrë. Po ia morën tani, sendi do të jetë i pakthyesëm, sepse s' do të mund të identifikohet.
73. Nëse tarifat nxitëse veç zbatohen, do të jetë vështirë me ditë me përpikëri pjesën që ka paguar z. Kurteshi. Në një rën anë, nuk mund të saktësohet se cila pjesë e faturës së rrymës është dhënë për BRE. Por edhe më zor do të jetë me njohë saktë dëmin e shkaktuar nga marrja e paligjshme e pronës në emër të tarifave të rrymës. Pakësimi i pronës ndikon në thuajse çdo hap të jetës së qytetarëve.
74. Në fund, periudha 12-vjeçare do ta shndërronte dëmin në një huadhënie të institucionalizuar që edhe nëse shlyhet do të përbënte pasurim të pabazë, mbi kurrizin e qytetarëve. Edhe nëse kompensohet dëmi ndaj z. Kurteshi, nuk mund të zhbëhet efekti i subvencionimit të paligjshëm, që do të krijojë një shtresë biznesmenësh të privilegjuar dhe të prirë ndaj pabarazisë shoqërore.
75. Rrjedhimisht, paditës-propozuesi ka lutur Gjykatën Themelore të pranojë kërkesën për shtyrje ekzekutimi, duke konstatuar rrezikun e dëmit. Themeloria ka miratuar kërkesën me të drejtë, dhe Gjykata e Apelit duhet ta vërtetojë këtë miratim.

Interesi publik kërkon shtyrjen

76. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk cenon interesin publik. Përkundrazi, interesi publik kërkon shtyrjen e ekzekutimit, meqë shtyrja mbron konsumatorin dhe tregun, ndërsa nuk pengon përmbushjen e caqeve për shfrytëzimin e BRE-së.
77. Republika e Kosovës tashmë ka realizuar cakun detyrues për 25-përqind energji nga burime të ripërtërishme. Ndërsa mbrojtja e konsumatorit dhe e tregut të lirë është në përputhje me interesin publik — madje detyrim kushtetues dhe ligjor i organeve të Republikës së Kosovës, përfshi të paditurën ZRrE.⁴¹

41 Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës (2008, ndryshuar së mbrami më 2016), neni 119; Ligj 05/L-084 për rregullatorin e energjisë, neni 1.1.

78. Ndikimi mjedisor i vendimit të ZRrE-së është i papërfillshëm, përkundër pretendimeve të ankuesve. Për arsye teknike e komerciale, subvencionimi i fotovoltaikëve nuk garanton më pak prodhim nga thëngjilli ajërndotës. Nga ana teknike, për të prodhuar më pak, termocentralet duhet të shkymbin gjeneratorët; dhe nëse shkymbin një gjenerator, humbin më shumë se 20 MWh që mund të përftohen nga dielli me skemën e ZRrE-së. Nga ana komerciale, termocentralet ofrojnë energji me çmim të volitshëm, andaj kanë leverdi të prodhojnë dhe rrymën ta eksportojnë kur nuk u shitet brenda vendit. Kësisoj, vendimi i ZRrE-së nuk ndihmon kundër ndotjes, andaj dhe shtyrja e ekzekutimit nuk cenon interesin publik për mjedisin.
79. Shtyrja thjesht pengon dëmin që u kanoset qytetarëve kosovarë, duke parandaluar edhe pasurimin e pabazë, me paratë të popullit.

Palët e interesuara nuk dëmtohen, madje përfitojnë nga shtyrja

80. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk u sjell dëm palëve.⁴² Vendimi i ZRrE-së parasheh dhënien e subvencioneve për një periudhë 12-vjeçare. Shtyrja e ekzekutimit nuk e pakëson kohëzgjatjen e subvencioneve. Madje, nëse veç lejohet ekzekutimi pas vendimit përfundimtar të gjykatës, prodhuesit do të përfitojnë nga tarifa të larta fikse, ndërkohë që çmimi i energjisë në treg shkon duke rënë.⁴³
81. Prodhuesit nuk kanë bërë kurrfarë investimi si rrjedhojë e vendimit të ZRrE-së, nuk kanë qenë palë në procedurë administrative, s'kanë pasur shkas të drejtpërdrejtë të presin përfitime, andaj dhe s'mund të pësojnë dëm nga pezullimi i vendimit. ZRrE ka caktuar tarifat nxitëse pa arsyetim dhe pa dëshmuar se ka llogaritur koston e prodhimit ose investimeve (përkundër pretendimeve të saj pas vendimit).
82. Për më tepër, asnjë palë e interesuar nuk ka arritur të provojë shpenzime lidhur me vendimin e ZRrE-së. Ankuesit përmendin shpenzime për të siguruar të drejta mbi paluajtshmëri dhe për zhvillime të biznesit, por të gjitha këto kanë ndodhur para vendimit të 27 nëntorit. Edhe nëse këto shpenzime i kanë bërë duke llogaritur në përfitimet nga tarifat

42 LKA, neni 22.2.

43 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, 24.12.2019, para. 98.

nxitëse, shpenzimet e tilla nuk është dashur të ndodhin pa kapërcyer afati për padi dhe pa u siguruar plotfuqishmëria e vendimit.

83. Rrjedhimisht, çfarëdo pengese që mund t'u shkaktohet prodhuesve të energjisë, si palë e interesuar, nuk përbën «dëm të madh» sipas kuptimit të nenit 22 të Ligjit për konfliktet administrative.
84. Paditës-propozuesi ka plotësuar kushtet për shtyrje të ekzekutimit dhe Themelorja me të drejtë ka miratuar kërkesën për shtyrje, andaj Gjykata e Apelit duhet ta vërtetojë Aktvendimin e 6 prillit.

D. Ankesa e palëve ka të meta thelbësore

Lëshohet në meritat e padisë

85. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rastin vetëm për aq sa lejohet për të vendosur mbi shtyrjen e ekzekutimit, sipas nenit 22 LKA. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit administrativ ngjason me masat e sigurimit të vendosura në procedurën kontestimore civile. Në cilindo rast, gjykata përmbahet nga vlerësimi i meritave të rastit. Gjykata nuk çmon nëse padia është e bazuar — kjo është punë për shqyrtimin përfundimtar — por nëse ka prova të besueshme për dëmin e kanosur.
86. Në pamundësi për ta goditur aktvendimin e Themelores brenda shkaqeve të lejuara, ankuesit tani përpiqen ta shtyjnë Gjykatën e Apelit drejt vlerësimit të meritave. Për shembull, në argumentet për interesin publik, thirren në zbatimin e së drejtës materiale, që përfshin detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Sipas tyre, shtyrja e ekzekutimit po pamundëson përmbushjen e detyrimeve ndaj Bashkimit Evropian dhe Komunitetit të Energjisë si dhe zbatimin e një udhëzimi administrativ për caqet e BRE-së. Por z. Kurteshi ka paditur ZRrE-në mu pse ka vendosur tarifa nxitëse, që ndalohen me normat e zbatueshme evropiane e vendore, dhe pse tarifat nuk i ka caktuar siç lypset me normat e zbatueshme.⁴⁴ Andaj, me marrë parasysh argumentin e ankuesve rreth këtyre normave i bie me vendosë mbi meritat e padisë.
87. Meqë ra fjala, zyra e BE-së dhe Komuniteti i Energjisë tashmë kanë kundërshtuar haptazi vendimin e ZRrE-së, sepse nuk përdor mjetet e

44 Padi dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, 24.12.2019, para. 6.

tregut të lirë.⁴⁵ Kurse udhëzimi administrativ — ligjshmëria e të cilit sfidohet në padinë e zotit Kurteshi — nuk përmban kurrfarë detyrimi për subvencionet. Udhëzimi vendos cakun e detyrueshëm në 25 për qind BRE, dhe Kosova e ka arritur këtë cak tashmë. Caku prej 29 për qind, sipas udhëzimit, është vetëm indikativ.⁴⁶

88. Ngjashëm, ankuesit pretendojnë se subvencionet nevojiten për të zëvendësuar importin e energjisë elektrike, dhe se pezullimi i vendimit të ZRrE-së cenon interesin publik për prodhim vendor. Por edhe ky argument prek meritat e padisë, që është ngritur kundër ndihmës së paligjshme shtetërore. Fundja, importi nuk mundet dhe s'ka pse të zëvendësohet kur megavati kosovar kushton mbi trefish më shumë se megavati i prodhuar në Shqipëri.⁴⁷ Subvencionet thjesht pasurojnë bizneset rentiere në kurriz të qytetarëve.
89. Duke vajtuar çështje si subjektiviteti ndërkombëtar i shtetit, ndotja e mjedisit dhe zëvendësimi i importit, ankuesit po mundohen njëherë t'i dobësojnë meritat e lëndës dhe pastaj ta nxisin gjykatën për t'i vlerësuar ato merita. Ky vlerësim s'bëhet në këtë fazë të procedurës.
90. Gjykata e Apelit duhet të kufizojë shqyrtimin brenda fushëveprimit të nenit 22 LKA, dhe pa u lëshuar në meritat e rastit, ta vërtetojë aktvendimet e shkallës së parë shtyrje të ekzekutimit.

Keqparaqet faktet dhe ligjin

91. Parashtrësarët tona disa herë kanë vënë në pah pretendime të ankuesve që shtrembërojnë faktet dhe bazën ligjore.⁴⁸ Këto huqje përsëriten në ankesën e 22 prillit, përkundër pritshmërisë së arsyeshme se ankuesit do të mënjanonin gabimet e tyre.
92. Siç kemi cekur tashmë, ankuesit dredhin dhe keqpërdorin faktet e ligjin në shumë pika: vendimi i ZRrE-së për të mos shtrenjtuar rrymën

45 Po aty, para. 29 dhe shtojcat 9–11.

46 Ligji 05/L-081 për energjinë, neni 15.1 (vë cakun në 25 për qind); Udhëzimi administrativ (MZhE) 05/2017 për caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, GZRK 30.6.2017, neni 3.

47 Shih para. 26 të kësaj përgjigjeje, sipër.

48 Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 13.2.2020; Përgjigje në ankesën e palës së interesuar, 21.2.2020; Parashtrësë e paditësit, 12.3.2020.

sivjet, shpenzimet e palëve (që nuk janë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të 27 nëntorit), ndikimi në mjedis, detyrimet ndërkombëtare, zëvendësimi i importit e çështje të tjera.⁴⁹

93. Veçse kulmojnë duke pretenduar se Kosova ka 2 milionë ora të rrymës, ani pse regjistrimet dhe vlerësimet e popullsisë nuk japin as 2 milionë banorë. Këta numra i fryjnë qëllimshëm: duke pjesëtuar koston minimale të subvencioneve për më shumë konsumatorë — 16 milionë euro për 12 vjet për 2 milionë konsumatorë — thonë se z. Kurteshit i bie të paguajë vetëm disa centë në vit. Kështu përqeshin paditësin si cikërrimtar që po ua pengon përfitimet milionëshe, ndërkohë që pyesin retorikisht nëse disa centë në vit mund të quhen dëm i pariparueshëm. Ligjërisht, përgjigja është po! Dhe e vërteta është se dëmi sillet nga qindra në mijëra euro për amvisëri, dhe se vendimi i drejtë i gjykatës do t'i kursente konsumatorit mesatar aq para sa të paktën me iu ble fëmijëve nga një palë çizme dimri.
94. Në disa raste, ankuesit kanë përmirësuar ankesat e tyre sipas vërejtjeve të paditës-propozuesit. Për shembull, përgjigja në ankesën e palës «Building Construction» ka zbuluar se pala nuk është e regjistruar si person juridik, nuk ka dhënë adresë të veten, emër përfaqësuesi as numër biznesi. Tash e mbas, palët e tjetra — të përfaqësuara nga të njëjtët avokatë — ceken në ankesë me numra identifikues, çka ua forcon pozitën në procedurë. Por nuk heqin dorë nga dredhimet absurde, që sado jobindëse bjerrin burimet e Gjykatës dhe palëve.
95. Përveç gabimeve të përsëritura, ankuesit tani keqçitojnë nenin 22 LKA, duke radhitur katër kushte që duhet plotësuar për shtyrjen e ekzekutimit. Si element shtesë përfshijnë kërkesën për të saktësuar lartësinë e dëmit. E vërteta është se neni 22 LKA ka vetëm tri kushte, dhe paditës-propozuesi i ka përmbushur të tria. Por ka plotësuar dhe kriterin që ankuesit kanë sajuar për t'i dhënë ngjyrë serioziteti një ankese tërësisht të pabazë.
96. Për këto arsye, Gjykata duhet të refuzojë ankesën e palëve të interesuara, dhe të vërtetojë Aktvendimit e 6 prillit 2020.

49 Shih para. 46, 78, 82, 86 dhe 88 të kësaj përgjigjeje, sipër.

V. PROPOZIM

97. Mbështetur në argumentet e mësipërme, dhe duke u thirrur në nenet 186.1, 196 dhe 209 të Ligjit për procedurën kontestimore dhe nenin 22 të Ligjit për konfliktet administrative, paditës-propozuesi i kërkon Gjykatës të nxjerrë këtë:

AKTVENDIM

- I. **Hidhet poshtë si e palejuar** ankesa e palëve të vetidentifikuara si «VBS» SH.P.K., me numër biznesi 70325365, dhe «Building Construction», pa adresë ose numër identifikues.
- II. **Refuzohet si e pathemeltë** ankesa e palëve të interesuara «Alsi & Co – Kosovë L.L.C.» SH.P.K. me numër unik identifikues 810875552, «Vita Energy» SH.P.K. me numër biznesi 71218376, «Abrazen LLC» me numër biznesi 70100453, «Energy Development Group Kosova» SH.P.K. me numër biznesi 71276643 dhe «Solar Gate LLC» me numër biznesi 71280888.
- III. **Vërtetohet** Aktvendimi i 6 prillit 2020 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, në lëndën A. nr. 3090/19.

**Përfaqësuesi i paditës-
propozuesit:**

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com